



Buletini Maj 2012 <http://kk.rks-gov.net/malisheve/www.malisheva-komuna.org>




KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 107- Maj 2012 ZYRA PËR INFORMIM - [http://kk.rks-gov.net/malisheve/](http://kk.rks-gov.net/malisheve/www.malisheva-komuna.org)
www.malisheva-komuna.org





Përmbajtja

Biblioteka e Malishevës “Sokol Kryeziu” përfiton 638 libra të botimeve “KOHA”	3
KKSB e vlerëson të qetë situatën e sigurisë në Malishevë.....	3
Këtë javë fillon realizimi i disa projekteve	4
Diskutohet për mundësitë e investimit në aspektin e teknologjisë informative.....	5
Prezantohet publikimi i Buletinit Vjetor 2011	5
Diskutohen një varg çështjesh që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e punëve.....	7
Ka filluar rregullimi i rrugës për te “Shpellës së Filadit” në Panorc	8
Nga mbledhja e dytë e Komitetit për Shëndetësi dhe Çështje Sociale.....	9
U mbajt një takim njoftues me kryetarë të fshatrave dhe drejtorë të shkollave	10
Komiteti për Politikë dhe Financa dha dy rekomandime për Kuvend	11
Aksionit “Ta pastrojmë Kosovën”, i bashkohen të gjitha institucionet e komunës, shoqëria civile dhe qytetarë të tjerë	11
Përfundoi punësoria e vizionit për hartimin e planit zhvillimor të Malishevës.....	12
KK e formoi Këshillin Organizativ për shënimin e 16 Qershorit.....	14
Filloi aksioni për spërkatjen kundër rriqrave	15
Gjimnazi i Malishevës, emërtohet me emrin e dëshmorit Hamdi Berisha	16
Ekspert epidemiologjik nga Europa vizitojnë Malishevën	17
Ri-dizajnohen zyrat e kadastrës	18



Biblioteka e Malishevës “Sokol Kryeziu” përfiton 638 libra të botimeve “KOHA”

Malishevë, 3 maj

Biblioteka Komunale e Malishevës “Sokol Kryeziu”, është pasuruar me një fond prej 638 librash, falë një donacioni të Grupit KOHA, në kuadër të shënimit të themelimit të gazetës “Koha Ditore”.

“Po ashtu, Biblioteka Komunale “Sokol Kryeziu”, është pasuruar edhe me 104 ekzemplarë të tjerë të dhuruar nga Biblioteka Kombëtare Universitare e Kosovës”, ka thënë përgjegjësjë e bibliotekave të Malishevës, znj.Hana Bytyçi.

“Falënderojmë Grupin KOHA që ka bërë një shpërndarje të tillë, e që për bibliotekën tonë është shumë e mirëseardhur, pasi titujt e dhuruar janë kërkesë e kahershme e lexuesve tanë”, tha me këtë rast, përgjegjësjë Bytyçi.

KKSB e vlerëson të qetë situatën e sigorisë në Malishevë

Malishevë, 3 maj



Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), mbajti takimin e rregullt të saj, dhe me këtë rast, anëtarët e këtij këshilli, e vlerësuan të qetë dhe stabile, situatën e sigorisë së përgjithshme në Komunën e Malishevës.

Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, z.Halit Zogaj, tha se “situata e sigorisë së përgjithshme, në territorin e Komunës së Malishevës, është e qetë dhe stabile, pa tendencë për përkeqësim të saj”.

Edhe komandanti i stacionit policor në Malishevë, togeri Bekim Begaj, e vlerësoi të qetë situatën e sigorisë së përgjithshme, përderisa raportoi për ngjarjet e muajit të kaluar. “Gjatë muajit të kaluar ka ndodhur një rast i rrëmbimit, por Policia e Kosovës, ka intervenuar me shpejtësi, duke shpëtuar



viktimën. Një rast tjetër i rëndë, është një vdekje aksidentale, në një kompleks banimi, ku ka humbur jetën një fëmijë, ndërsa nuk ka pasur raste të tjera shqetësuese”, tha Begaj.

Në mbledhjen e sotme, u diskutua edhe për situatën epidemiologjike (ethet hemorragjike). Sipas drejtorit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, z. Skënder Hoti, “deri më tani janë shënuar 40 raste të thumbimit nga rriqrat dhe një rast ka rezultuar me infektim nga ethet hemorragjike, por personi është jashtë rrezikut për jetë”. Hoti, bëri të ditur, se edhe këtë vit, pas përfundimit të fushatës së vetëdijesimit, përmes ligjëratave, do të vazhdohet me spërkatjen e zonave endemike.

Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, z. Halit Zogaj, njoftoi për fushatën e Shërbimit të Zjarrfikësve, si masë parandaluese për mbrojtje kundër zjarreve.

Këtë javë fillon realizimi i disa projekteve

Malishevë, 7 maj

Në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, e udhëhequr nga Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, është njoftuar se nga dita e sotme, do të filloj shpërndarja e materialit ndërtimor, për katër familje skamnore, për ndërtimin e shtëpive të tyre. “Përmes kësaj shpërndarjeje, komuna i ndihmon këto katër familje, që të sigurojnë strehë dhe kulm mbi kokë”, tha kryetari Kilaj. Familjet që do të ndihmohen me material ndërtimor janë në Drenovc (Elez Morina), Guncat (Salih Osman Gashi), Senik (Bedri Mujë Jonuzaj) dhe Gurbardh (Remzi Berisha), gjendja ekonomike e sociale, e së cilave është e vështirë.

“Ndërsa një projekt tjetër, është edhe fillimi i punimeve në Shpellën e Panorcit, që do të duhet të filloj nesër (e marte), projekt i cili shënon fillimin e investimeve në sektorin e turizmit, përmes së cilit synohet jo vetëm zhvillimi i këtij sektori, por edhe zhvillimi ekonomik”, tha mes tjerash kryetari Kilaj.

Në këtë mbledhje, po ashtu u njoftua se është marrë konfirmimi, se që nga kjo javë do të filloj edhe sanimi i dëmeve nëpër rrugët e qytetit, si dhe vazhdimi i punimeve në fushën e futbollit të madh.

Ndërsa, për situatën epidemiologjike, nga ethet hemorragjike, drejtori për shëndetësi, z. Skënder Hoti, tha se “me gjithë numrin e madh të të thumbuarve nga rriqrat, situata është nën kontroll, edhe pse disa raste janë të dyshuara dhe po trajtohen në Klinikën Infektive, por deri më tani nuk janë të konfirmuara me ethe hemorragjike”.



Midis USAID-DEMI dhe kryetarit të Malishevës

Diskutohet për mundësitë e investimit në aspektin e teknologjisë informative

Malishevë, 10 maj

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka pritur në takim udhëheqësen e Njesisë për Administratë dhe Kuvend, nga USAID-DEMI, znj. Debora Kimble, me ç'rast janë diskutuar mundësitë për investim në aspektin e teknologjisë informative, në objektin e ri, i cilësuar Qendra e Bizneseve, në të cilin do të jenë të vendosur edhe një pjesë e stafit administrativ komunal.

Me këtë rast kryetari Kilaj, ka falënderuar zonjën Kimble, për bashkëpunimin e deritashëm, në realizimin e disa projekteve së bashku, ndërkohë ka parashtruar nevojën për një investim të mundshëm, në objektin e lartpërmendur.



“Ju falënderoj për bashkëpunimin tuaj si USAID-DEMI, ngase së bashku kemi realizuar disa projekte. Ju e dini që së shpejti presim ta përurojmë edhe objektin e bizneseve në të cilin do të jetë e vendosur edhe një pjesë e stafit administrativ, për ç’gjë nevojitet investim në aspektin teknologjik, konkretisht pajisje kompjuterike, por edhe digjitalizimi i regjistrimit të punëtorëve, në rastet e hyrje daljeve”.

Udhëheqësja e Njesisë për Administratë dhe Kuvend, znj. Debora Kimble, ka premtuar se do të shqyrtojnë mundësitë për një investim të tillë, gjë që sipas saj, ndërlidhet me ngritjen e performancës së administratës nëpër komuna, që është edhe misioni i USAID-DEMI-it.

Prezantohet publikimi i Buletinit Vjetor 2011

Malishevë, 11 maj

Zyra për Informim Publik në kuadër të Komunës së Malishevës, sot ka organizuar një takim me gazetarët, përfaqësues të subjekteve politike në Kuvendin Komunal, përfaqësues të shoqërisë civile,



OSBE, KDI, me qëllim që të bëjë publike printimin e Buletinit Vjetor 2011, projekt i përbashkët me USAID-in, Programi Iniciativa për Komunitet Demokratik dhe Efektiv -DEMI.



Buletini Vjetor i Komunës Malishevës, pasqyron ngjarjet dhe aktivitetet e realizuara nga qeveria dhe Kuvendi Komunal në periudhën një vjeçare. Synim i printimit të këtij buletini është informimi i qytetarit dhe dokumentimi i punës së Komunës së Malishevës.

Pjesëmarrës në takim ishin kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, kryesuesi i kuvendit, z. Ragip Begaj, përfaqësues të kuvendit, pjesëtar të shoqërisë civile, përfaqësues të OSBE, KDI-së, dhe gazetarët nga komuna jonë që raportojnë për mediet e nivelit

qendror.

“Ne si komunë falënderojmë USAID-DEMI-in, konkretisht znj. Melihate Limani, dhe z. Nijazi Kuçi, për bashkëpunimin dhe përkrahjen e tyre, në realizimin e projektit të Buletinit Vjetor-2011. Ky projekt publikimit të këtij buletini vjetor, e pasuron punën tonë njëvjeçare. Njëkohësisht përgëzoj edhe zyrën për informim për punën e bërë në grumbullimin e informacioneve dhe formën e dokumentimit të tyre”, është shprehur midis tjerash kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, në fjalimin e tij falënderues ndaj USAID-it, i cili njëkohësisht ka falënderuar edhe gazetarët për pasqyrimin korrekt të ngjarjeve dhe aktiviteteve të komunës. Me këtë rast kryetari Kilaj ka përmendur edhe disa nga projektet që janë realizuar ose që janë në realizim e sipër me USAID-DEMI-in, si: ujësjellësi në Turjakë, Damanek, Bubël, Lladrovç (në përfundim e sipër), shkolla/aneksi në Marali, renovimi i shkollës së Gurbardhit, nënkalimi në Astrazup, renovim i Sallës së Kuvendit Komunal, në hartim e sipër Rregullorja për organizmin e brendshëm të administratës komunale, etj.

Në anën tjetër përfaqësuesja e USAID-it, znj. Melihate Limani në fjalimin e saj tha: “shfrytëzoj rastin ta përgëzoj kryetarin dhe komunën e Malishevës për publikimin e buletinit. Kjo e ka rëndësinë e vet, pasi po bëhet dokumentimi i punës së Komunës së Malishevës dhe po i ofrohet qytetarit të Malishevës, informacion për të gjitha ato që kanë ndodhur në Komunën e Malishevës, përfshirë këtu punën e qeverisë komunale dhe Kuvendit Komunal. DEMI dhe Komuna e Malishevës, kanë punuar në projekte të ndryshme, për përmirësimin e jetës së qytetarit, mirëpo ajo që vlen të vlerësohet shumë lart është se, çdo ditë e më tepër komuna po tregohet më e hapur me qytetarin dhe po i kushtohet rëndësi transparencës dhe këtë e dëshmon edhe buletini që sot po prezantohet”. Më tutje, janë përmendur edhe projektet që po realizohen në bashkëpunim me DEMI dhe rëndësinë që kanë ato projekte në ndikimin e drejtpërdrejt tek qytetari, në rritjen e cilësisë së jetesës.



Lëvdatë për realizimin e këtij projekti, shprehu edhe Isa Ulluri, nga shoqëria civile.

Vlen të theksohet se Zyra për Informim Publik, e mbështetur nga USAID- DEMI është në përgatitje edhe të materialeve tjera informuese për qytetarët si: broshura apo fletëpalosje informuese për secilën drejtori, që ndërlidhet me transparencën dhe informacione mbi shërbimet e ofruara nga komuna.

Zyra për Informim konsideron se ka pasur fatin që në mesin e vetëm disa komunave të Republikës së Kosovës, të jet përfituese e projektit për printimin e Buletinit Vjetor, dhe po ashtu ka krijuar një bashkëpunim të mirë me projektin e USAID - DEMI.

Nga mbledhja e Bordit të Drejtorëve

Diskutohen një varg çështjesh që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e punëve

Malishevë, 11 maj

Në mbledhjen e sotme të Bordit të Drejtorëve, e cila është mbajtur sot, janë diskutuara një varg çështjesh që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e punëve të komunës.

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, dhe stafi i tij, kanë diskutuar për mundësitë e ndërtimit të shkollës fillore në Vërmicë, pastaj për pastrimin e mbeturinave në ambiente të hapura, për 16 Qershorin, Ditën e Çlirimit dhe Ditën e Dëshmorëve të Komunës sonë, etj.

Çështje tjetër e diskutuar ishte edhe ngritja e kapacitetit të ujësjellësit të Banjës, prej të cilit furnizohen edhe disa fshatra të tjera të Komunës së Malishevës.





Ka filluar rregullimi i rrugës për te “Shpellës së Flladit” në Panorc

Malishevë, 14 maj

Rreth 20 vjet pas zbulimit të saj, ka filluar rregullimi i “Shpellës së Flladit” në Panorc, lokalitet ky 17 kilometra larg qendrës komunale të Malishevës kurse pas rreth dy muajve të punës efektive llogaritet se ky atraksion turistik do të hapet edhe për qytetarët të cilët do të njihen nga afër me pasuritë dhe bukurinë e saj.

Merret vesh se në fazën e parë do të bëhet hapja e rrugës e cila dërgon deri në hyrje të shpellës si dhe zgjerimi i hyrjes së saj pasi aktualisht depërtimi në kanalet e saja është gati i pa mundur për shkak të hyrjes së saj të ngushtë.

“Konsiderojmë se po fillojmë një projekt të rëndësishëm në fushën e turizmit të cilit në të ardhmen do t’i kushtohet më shumë kujdes pasi mund të jetë një sektor që do të ndikoj në zhvillimin ekonomik të

komunës”, ka thënë Isni Kilaj, kryetar i komunës duke e konsideruar shpellën në Panorc si një atraksion të veçantë turistik në të cilin ja vlen të investohet.

Fshati Panorc gjendet në pjesën perëndimore të territorit të komunës së Malishevës kurse shpella që është një monument natyror nëntokësor gjendet rrëzë maleve të Zatriçit që e ndajnë territorin e kësaj komune me komunën e Rahovecit.

Shpella është zbuluar në vitin 1992 nga një banorë i fshatit dhe sipas ekspertëve është krijuar me lëvizje tektonike dhe zhvendosje përderisa uji ka skalitur shumë galeri interesante dhe figura tërheqëse për vizitor.

Hyrja në shpellë në largësi prej 5-6 metra është shumë e ngushtë, por brendësia është e kalueshme përafërsisht prej 400-500 metra kurse në brendi të saj ka sasi të konsiderueshme të ujit, i cili deri më tani ka qenë pengesë serioze e hulumtimit të plotë të saj.

Shpella e ka marrë emrin “Shpella e Flladit”, nga arsyeja se uji që gjendet në shpellë dhe rrymimet e ajrit në çdo kohë janë të ftohtë kurse karakteristike e saj është se janë vërejtur stallagmitet dhe stallaktite të cilat kanë shumë ngjashmëri me ato të shpellës së Gadimes kurse ka të formësuara edhe korridore dhe hapësira të shumta.

Në KK të Malishevës bëjnë të ditur se hulumtimi i parë më serioz në shpellë është bërë gjatë vitit 2002 , nga një ekip spereologësh gjerman ISAAK të cilët kanë bërë hulumtime pothuaj në tërë gjatësinë e shpellës përkundër pengesave që kanë pas nga sasia e madhe e ujit të rrjedhshëm.



Në gjatësinë e hulumtuar ndërkaq ekipi ka konstatuar se shpella është e pasur me stallaktite, tallagmite, pllaka të mermerta dhe stoli tjera shpellore.

Është vërejtur po ashtu se brendia e shpellës është e pasur me labirinte, lumej dhe liqej të shumtë kurse mermeri në shpellë për nga ngjyra është i ndryshëm si i hirtë, i verdhë pastaj është prezent edhe mermeri i bardhë që i përngjan akullit. Ata që kanë hyrë në shpellë ndërkaq stilive të saj u kanë dhënë emra të ndryshëm varësisht nga forma si “shqiponja”, “minarja e xhamisë”, “stufa”, “qielli me yje” e të tjera. Ndryshe, ky është investimi i parë në Malishevë në një objekt të tillë turistik kurse në këtë komunë janë të njohura edhe dy shpella të tjera në Ngucat dhe në Temeqinë të cilat ende nuk janë hulumtuar sa duhet.

Nga mbledhja e dytë e Komitetit për Shëndetësi dhe Çështje Sociale

Malishevë, 15 maj



Komiteti për Shëndetësi dhe Çështje Sociale, ka mbajtur sot takimin e dytë, pas atij konstituues, me ç’rast janë diskutuar katër pika të rendit të ditës.

Kryesuesi i këtij komiteti, z. Besnik Hoti, para anëtarëve ka prezantuar rendin e ditës, që ishin miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, diskutimi rreth mundësisë së rikthimit të punës apo ndërrimit të dytë në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Kijevë, gjendja aktuale në komunë sa i përket pickimit nga rriqrat dhe gjendja e përgjithshme e shëndetësisë në Malishevës, skema e

përfituesve të ndihmës sociale , dhe të ndryshme.

Nga ky takim, rezultuan dy rekomandime për kuvend. Rekomandimi i parë ka të bëjë me rikthimin e ndërrimit të dytë të punës në QMF në Kijevë dhe shqyrtimi i gjendjes së përgjithshme nga rreziku i rriqrave në territorin e Komunës së Malishevës (raport për tri vitet e fundit nga drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë në lidhje me këtë çështje).



Me rastin e 24 Majit "Ta pastrojmë Kosovën"

U mbajt një takim njoftues me kryetarë të fshatrave dhe drejtorë të shkollave

Malishevë, 18 maj

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj dhe drejtorët z. Halit Zogaj- Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe z. Alban Kastrati- Drejtoria për Shërbime Publike, kanë mbajtur një takim me kryetarët e fshatrave dhe drejtorët e shkollave të komunës. Qëllimi i takimit kishte të bëjë me informimin e fushatës "Ta pastrojmë Kosovën", e cila do të organizohet në mbarë territorin e Republikës së Kosovës.



"Fushata "Ta pastrojmë Kosovën", ka për qëllim mobilizimin e qytetarëve të Kosovës për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit, e që ajo ditë të jetë edhe më e suksesshme ajo meriton edhe vëmendjen dhe ndihmën e Komunës suaj", thuhet midis tjerash në një shkresë të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikim Hapësinor, dërguar kryetarëve të komunave të Republikës së Kosovës.

Në fjalën e tij kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka falënderuar pjesëmarrësit, të cilët në mënyrë masovike i janë përgjigjur ftesës për këtë takim, ndërsa i ka njoftuar ata për qëllimin e këtij takimi. Z. Kilaj shprehu shqetësimin e çështjes së mbeturinave në territorin e Komunës së Malishevës. " Njëra ndër problematikat e mëdha në Komunën e Malishevës, është çështja e mbeturinave. Ne të gjithë së bashku duhet të bëjmë përpjekje maksimale për ta ruajtur ambientin, por edhe për të sensibilizuar qytetarët se hedhja e mbeturinave vend e pa vend, është e ndaluar me ligj".

Sqarime rreth 24 Majit, dhanë edhe drejtorët Halit Zogaj e Alban Kastrati, sipas të cilëve, aksioni për pastrimin e ambientin nga mbeturinat, në tërë territorin e Komunës së Malishevës, do të filloj në ora 10. Sipas agjendës së përgatitur nga drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Shërbime Publike: " drejtorët e shkollave të Komunës së Malishevës do të merren me menaxhimin e situatave, personelit vullnetar (përkatësisht nxënësve të shkollave të tyre), ndërsa kryetarët e fshatrave do të organizojnë grumbullimin e mbeturinave". Mbeturinat e grumbulluara do të barten nga Njësia e Ekoregjionit, por do të angazhohen edhe kompani private, për të cilat komuna do siguroj derivatet.

Në këtë ditë do të jenë të përfshira edhe institucionet lokale të komunës së Malishevës, por edhe KFOR-i, FSK dhe Policia e Kosovës.



Vlen të përmendet se kjo nisëm është përkrahur nga të pranishmit, të cilët edhe kanë dhënë ide që në të ardhmen në vendbanime ose në vende publike të vendoset edhe tabela informuese, në lidhje me sanksionim me ligj, të hedhjes së mbeturinave në vende publike.

Komiteti për Politikë dhe Financa dha dy rekomandime për Kuvend

Malishevë, 21 maj

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), i udhëhequr nga kryesuesi i Asamblesë Komunale, z. Ragip Begaj, ka mbajtur sot mbledhjen e saj të njëzetedytë të radhës dhe ka dhënë dy rekomandime për mbledhjen e ardhshme të Asamblesë.

KPF ka shqyrtuar dhe e ka rekomanduar për Kuvend, kërkesën e Kryetarit të Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, për fillimin e procedurave për formimin e Këshillit Organizativ, për shënimin e 16 Qershorit-Ditës së Çlirimit dhe Dëshmorëve të Malishevës.

Po ashtu, KPF-ja, për Kuvend ka rekomanduar edhe njoftimin e Drejtorisë Komunale për Arsim dhe Edukim, për planifikimin për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë për vitin shkollor 2012-2013 dhe përgatitjet për përfundimin e vitit shkollorë 2011-2012 dhe përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2012-2013.

Aksionit “Ta pastrojmë Kosovën”, i bashkohen të gjitha institucionet e komunës, shoqëria civile dhe qytetarë të tjerë

Malishevë, 24 maj

Aksionit “Ta pastrojmë Kosovën”, i janë bashkuar të gjitha institucionet e komunës së Malishevës, , shoqëria civile dhe qytetarë të tjerë.

Ky aksion në komunën e Malishevës është menaxhuar nga Drejtoritë Komunale, ajo për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe e Shërbimeve Publike.

Stafit të administratës komunale, për pastrimin e Malishevës, që nga ora 10:00, i ka prirë kryetari i Komunës, z. Isni Kilaj.



Sipas drejtorit të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, z. Halit Zogaj, “në Komunën e Malishevës, janë ndërmarrë të gjitha masat organizative për largimin e mbeturinave nga vendet publike, në mbarë territorin e Komunës së Malishevës”. Të përfshirë në këtë çështje janë angazhuar edhe 12 kompani private, përveç atyre publike që janë “Ekorigjioni” dhe “Hidroregjioni”, të cilat po i bartin mbeturinat e grumbulluara, për t’i dërguar ato në deponinë legale në Prizren. Në largimin e këtyre mbeturinave kanë qenë të përfshira këto makineri: 9 kamiona, 4 skipa, 2 bagera, por edhe

12 traktor dhe 4 kamioneta.

Vlen të përmendet se deri më tani (ora 15:00), në mbarë territorin e Komunës së Malishevës, janë grumbulluar rreth 49 tonë mbeturina, ndërsa janë hequr apo larguar 22 deponi mbeturinash ilegale, edhe pse për shkak të kushteve atmosferike, nga shiu i pandërprerë, ka pasur probleme për qarkullimin e makinerisë.

Ky aksion është mbështetur edhe nga Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi (EVSB), të Komunës së Malishevës.



Përfundoi punëtorja e vizionit për hartimin e planit zhvillimor të Malishevë

Malishevë, 25 maj

Ka përfunduar punëtorja katër ditore e vizionit, në kuadër të projektit për hartimin e planit zhvillimor të Malishevës. Kjo punëtori, është faza e dytë e këtij projekti, që kishte për qëllim, caktimin e strategjisë për zhvillimin e komunës, për 13 vitet e ardhshme. Projekti i hartimit të planit zhvillimor të Malishevës, përkrahet nga UN-HABITAT-i.

Në ditën e katërt të kësaj punëtorie, grupi punues për hartimin e planit zhvillimor, ka bërë prezantimin e objektivave dhe identifikimin e strategjive për zhvillim. Grupet punuese, kanë prezantuar strategjitë e zhvillimit në banim, shërbime publike, zhvillim ekonomik, infrastrukturë, mobilitet, mjedis dhe trashëgimi kulturore.

Në këtë prezantim, përveç kryetarit të Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, kanë marrë pjesë edhe zyrtarët më të lartë të UN-HABITAT-it, të prirë nga znj. Krystyna Galezia, ndërkohë i tërë grupi ka qenë i përbërë nga 24 persona, zyrtarë komunal dhe nga shoqëria civile.



“Nuk kam dilemë se parashikimet e juaja, të hedhura në letër, do të realizohen në një të ardhme jo të largët. Një nga problemet kryesore, që do të ballafaqohet Malisheva, është ruajtja e tokës bujqësore, apo kufizimi i hapësirës ndërtimore, si nevojë e ruajtjes së tokës bujqësore dhe zonave të gjelbra. Sa i përket infrastrukturës, nuk e kemi këtë problem, pasi shumica e rrugëve janë ndërtuar dhe është krijuar një bazë shumë e mirë. Po ashtu edhe rrjetet e kanalizimit që këtë vit e kemi objektiv t’i përfundojmë të gjitha, përfshi edhe kolektorin kryesor. Sigurisht se ka hapësirë për më shumë ide për zhvillimin ekonomik dhe deri në përfundim të këtij projekti, të gjitha do të përfshihen në hartimin e planit zhvillimor të Malishevës. I përgëzoj të gjithë për punën e bërë”, tha mes tjerash Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj.

“Ju përgëzoj për punën e bërë, për prezantimin e këtij vizioni për Malishevën, për identifikimin e çështjeve, që ndikojnë në zhvillimin e përgjithshëm të Malishevës”, tha znj. Krystyna Galezia, duke folur për punën e bërë gjatë katër ditëve të punëtorisë. Ajo më pas, edhe i komentoi me radhë të strategjitë e prezantuara nga grupet e punës.



KK e formoi Këshillin Organizativ për shënimin e 16 Qershorit

Malishevë, 29 maj

Asambleja Komunal e Malishevës, në mbledhjen e XXVII të radhës, mori vendim për formimin e Këshillit Organizativ për shënimin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Ditës së Dëshmorëve të Komunës së Malishevës. Po ashtu në këtë mbledhje janë marrë edhe vendime të tjera, si dhe kanë raportuar para asamblistëve, drejtorët për arsim dhe shëndetësi.

Këshilli Organizativ për shënimin e 16 Qershorit, do t'i ketë 13 anëtarë dhe do të jetë i udhëhequr nga Kryetari i Komunës, ndërsa anëtarët tjerë, do të jenë, kryesuesi

i KK-së, përfaqësues të partive të përfaqësuara në Asamble, organizatat e dala nga lufta e UÇK-së dhe shoqëria civile, ndërsa LDK-ja, ka deklaruar se nuk do jetë pjesë e organizimit për shënimin e 16 Qershorit.



Me shumicë votash, Asambleja ka miratuar kërkesën e kryetarit të Komunës nr. 01/557 datë 21.05.2012 për kushtëzimin e lëshimit të vërtetimit të tatimit në pronë, për përfituesit e shërbimeve nga njësitë “ Ekoregjioni ” dhe “ Hidroregjioni ”, me rastin e regjistrimit të automjeteve.

Asambleja Komunale, po ashtu ka miratuar edhe listën e Këshillit të Ekspertëve për Planifikim, i cili do t'i ketë nëntë anëtar, ekspertë të fushave të ndryshme. Edhe në këtë këshill, LDK nuk ka ofruar emra.

Në këtë mbledhje, me kërkesën e këshilltarëve komunal, për gjendjen në arsimin e Malishevës, ka raportuar drejtori për Arsim dhe Edukim, z.Ismail Morina, lidhur me planifikimin për regjistrimin e nxënësve në klasën e parë, viti shkollor 2012-2013, si dhe përgatitjet për përfundimin e vitit shkollor 2011/2012 dhe fillimin e vitit shkollor 2012/2013.

Po ashtu, ka raportuar edhe drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Skënder Hoti, për situatën epidemiologjike nga ethet hemorragjike “Krimet Kongo”, si dhe për kërkesën që QMF në Kijevë të punoj në dy ndërrime. Për këtë të fundit, me shumicë votash, i është kërkuar Drejtorisë së Shëndetësisë, që të organizohet puna në dy ndërrime, në këtë QMF.

Në fund të seancës së sotme, këshilltarët komunal, vendosën që të shtojnë edhe një pikë për rend dite, për seancat e ardhshme, që ka të bëjë me deklaratimet jashtë rendit të ditës.

Filloi aksioni për spërkatjen kundër rriqrave

Malishevë, 30 maj



Sot, nga ora shtatë e mëngjesit, organizuar nga Drejtoritë Komunale për Shëndetësi, Mbrojtje dhe Shpëtim dhe ajo e Bujqësisë, të mbikëqyrura nga Instituti Rajonal i Shëndetit Publik, për të tretin vit me radhë, ka filluar aksioni për spërkatjen e zonave endemike, kundër rriqrave, në kuadër të masave mbrojtëse kundër etheve hemorragjike.

Në aksionin e spërkatjes së 39 zonave endemike, marrin pjesë 25 persona të ndarë në grupe, ndërsa në ditën e parë, po spërkatën zona e Malishevës dhe lagjja Pallanka e Dragobilit.

Sipas drejtorëve për Shëndetësi dhe Mbrojtje e Shpëtim, z.Skënder Hoti, përkatësisht z.Halit Zogaj, aksioni do të zgjat tridhjetë ditë dhe përfshin të gjitha zonat, që konsiderohen endemike dhe vatra të mundshme të infeksionit me ethe hemorragjike, si pasojë e thumbimit nga rriqrat.

Drejtori për Shëndetësi, z.Skënder Hoti, me këtë rast tha se “këtij aksioni, i ka paraprirë një fushë vetëdijesuese për rrezikun e thumbimit nga rriqrat dhe masat që duhet të merren për largimin e tyre”. “Ky është viti i tretë radhazi që merremi me spërkatjen e zonave endemike dhe rezultatet e para tashmë janë evidente, pasi vitin e kaluar, nuk kemi pasur raste të infektimit me ethe hemorragjike dhe rrjedhimisht as raste fatale. Këtë vit e kemi të shënuar një rast të infektimit, por shpresojmë të mos kemi raste të tjera”, tha drejtori Hoti, duke bërë thirrje për kujdes të shtuar gjatë këtyre dy-tre muajve.

Ndërsa drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim, z.Halit Zogaj, ka njoftuar se “vonesa e fillimit të këtij aksioni për këtë vit, është pasojë e kushteve atmosferike”.

Gjimnazi i Malishevës, emërtohet me emrin e dëshmorit Hamdi Berisha

Malishevë, 30 maj

Në ditën e shkollës, në shënimin e 25 vjetorit të punës së tij, Gjimnazi në Malishevë, nga sot, do të mbajë emrin e dëshmorit të kombit dhe ish profesorit të kësaj vatre mësimore, Hamdi Berisha.

Me rastin e shënimit të ditës së këtij gjimnazi dhe riemërtimit të tij, përveç familjarëve të profesorit dëshmor Hamdi Berisha, morën pjesë edhe strukturat e larta komunale, prirë nga Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, pastaj nga Qeveria e Kosovës, zv/ministri i punës dhe Mirëqenies Sociale, z.Fatmir Shurdhaj, deputet të Parlamentit të Kosovës dhe qytetarë e bashkëluftëtar të shumtë të profesor Hamdi Berisha.



“Kur flasim për dëshmorin e kombit Hamdi Berisha, kemi emocion, mall, dashuri dhe krenari. Kemi emocione, sepse të dridhet zëri kur flasim për shokun tonë që e njohëm, që punuam bashkë, që luftuam dhe sot nuk e kemi këtu fizikisht; kemi mall, sepse e deshëm, e çmuam dhe ruajtëm kujtime të bukura për Hamdiun; krenari, sepse jeta që bëri Hamdiu, vepra e tij, lufta, heroizmi dhe flijimi për popull, për Kosovën, është krenari dhe vlerë e përjetshme; dashuri, sepse ata që e deshën më së shumti, fëmijët, prindërit, vëllezërit, motrat, shokët, e ruajnë dashurinë e amshueshme për Hamdiun. Nga sot Gjimnazi ynë, me emër të ri, do të ketë shkëlqim të ri, rrezatim e dritë të përjetshme, ashtu siç ishte jeta dhe vepra e dëshmorit të kombit Hamdi Berisha”, kështu tha mes tjerash Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj në fjalën e ti të mbajtur me rastin e riemërtimit të Gjimnazit, nga “Abdyl Frashëri” në “Hamdi Berisha”.

Ndërsa drejtori i Gjimnazit “Hamdi Brisha” në Malishevë, z.Agim Samadraxha, në fjalën e tij, foli për historikun e gjimnazit dhe për sukseset e arritura. Ai po ashtu njoftoi edhe për ndarjen e shpërblimeve tradicionale, për mësuesit dhe nxënësit më të dalluar të këtij gjimnazi.



Pllakën me emërtimin e ri të gjimnazit, e zbuluan, babai i dëshmorit, z.Sadri Berisha, Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, zv/ministri i MPMS-së, z.Fatmir Shurdhaj, invalidi i luftës dhe bashkëluftëtari i dëshmorit, z.Hazir Thaçi dhe profesori z.Ramiz Sopaj, ish kolegë i dëshmorit prof. Hamdi Berisha.

Në emër të familjes së dëshmorit Hamdi Berisha, të pranishmit i ka përshëndetur, vajza e dëshmorit, Fitore Berisha.

Gjimnazi “Hamdi Berisha”, ka 2170 nxënës, në 48 paralele dhe është institucioni më i madh i shkollimit të mesëm në Malishevë.

Ekspert epidemiologjik nga Europa vizitojnë Malishevën

Malishevë, 31 maj

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka pritur sot në takim një grup ekspertësh të etheve hemorragjike krimekongo, nga disa shtete evropiane, të prirë nga Dr.Isuf Dedushaj-epidemiolog, nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, si dhe znj.Nurishahe Hulaj-drejtoreshë e Institutit Rajonal të Shëndetit Publik.

Delegacioni i ndërkombëtarëve përbëhej prej ekspertëve nga Belgjika, Suedia, Franca, Turqia, Shqipëria, Sllovenia, Greqia, Gjermania, me ç’rast është biseduar për situatën e etheve hemorragjike krimekongo, në Komunën e Malishevës.



Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka njoftuar të pranishmit me një kronologji të përgjithshme të komunës që ai drejton, për tu ndalur më pas te situata e etheve hemorragjike, e që sipas tij “nga viti 2001, në komunën e Malishevës, nga ethet hemorragjike kanë humbur jetën 11 persona, ndërsa të infektua deri tani kanë qenë 217”. Një sqarim të tillë e ka dhënë edhe drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, z. Skënder Hoti.

Poashtu delegacioni ndërkombëtar u njoftua se që nga dje ka filluar spërkatja selektive e zonave endemike, në territorin e Komunës së Malishevës, e tëra kjo me mjete nga buxheti i komunës.



Në këtë takim, u diskutua për mundësitë e trajtimit të kësaj situatë, në përmasa ndërkombëtare, pasi që Komuna e Malishevës, si e vetme, nuk mund t'ia dalë të eliminoj njëherë e përgjithmonë këtë fenomen, që tash e sa vite e përcjellë këtë pjesë të Kosovës.

Në anën tjetër përfaqësuesit e të gjitha shteteve evropiane që ishin prezent në këtë takim, kanë falënderuar kryetarin për pritjen, ndërkohë që u shprehën optimist, që në një të ardhme të afërt të bëjnë edhe zbulimin e një vaksine për mbrojtje ndaj etheve hemorragjike.

Ri-dizajnohen zyrat e kadastrës

Malishevë, 31 maj

Kryetari i Komunës së Malishevës, z.Isni Kilaj, ka pritur në një takim pune, kryeshefin e Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK), z. Murat Meha, me të cilin kanë nënshkruar memorandumin e mirëkuptimit, për ri-dizajnimin e zyrave të kadastrës në Komunën e Malishevës, projekt ky, i cili realizohet në bashkëfinancim me Bankën Botërore.

“Banka Botërore, e përkrah këtë projekt përmes së cilit do të bëhet renovimi i zyrave të shërbimit kadastral, orenditë, pajisjet dhe arkiva e zyrave, me qëllim të përmirësimit të shërbimeve ndaj qytetarëve”, tha kryeshefi i AKK-së, z.Murat Meha.



Kryeshefi Meha, po ashtu lavdëroi punën e shërbimit kadastral në Malishevë, pasi siç tha ai, “kadastra në këtë komunë i ka futur të dhënat në sistem, për çka palët nuk presin fare dhe pajisen shumë shpejt me dokumentacionin e nevojshëm”.